

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori III, 2014

Tiranë, më 05 Dhjetor: Në tremujorin e tretë të vitit 2014, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 103,1 % kundrejt vitit 2010. (Viti 2010 = 100).

Në tremujorin e tretë 2014 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është 0,3 %. Rritjen më të lartë e kanë shënuar çmimet e prodhimit në seksionet: “ Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 3,1 % dhe “Industri nxjerrëse” me 1,9 %. Çmimet më të ulëta vërehen në seksionin “Industri përpunuese”, e cila shënon një ulje vjetore 0,1 %.

Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2013, çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar rritje me 1,0 %. Çmimet e prodhimit të produkteve vendase shënuan një rritje prej 0,2%

Në tremujorin e tretë 2014 ndryshimi tremujor i indeksit është 0,1 %. Çmimet e Prodhimit në seksionin “Industri Nxjerrëse” shënuan rritje me 1,0 %. Rritjen më të lartë e shënuan çmimet e prodhimit në aktivitetin “Nxjerrja e mineraleve metalore” me 2,3 %.


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve të industrisë përpunuese shënoi ulje me 0,3 %. Brenda saj mund të përmendet ulja e çmimeve të produkteve në aktivitetet: “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 6,7 % dhe “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 2,1 %. Ndërsa çmimet e prodhimit të produkteve në aktivitetet: “Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre”, “Prodhimi i paisjeve elektrike” dhe “Përpunimi i tekstileve” shënuan rritje respektivisht 2,4 %, 1,9 % dhe 1,4 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase arriti 102,5 % duke shënuar një ulje me 0,1 % krahasuar me tremujorin e dytë 2014 (Viti 2010 = 100). Vlen të përmendet ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionin “Industri Përpunuese” me 0,3 %. Ndërsa çmimet e prodhimit të industrisë nxjerrëse kanë shënuar rritje me 1,0 %.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit arriti 104,2 % duke shënuar një rritje me 0,3 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar rritje në seksionin “Industri nxjerrëse” me 4,5 %. Brenda saj mund të përmendet rritje e çmimeve të produkteve në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 6,1 %.

Për publikim 05/12/2014

Fig.1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit sipas muajve, Janar 2013 – Shtator 2014



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2010=100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	07 - 14	08 - 14	09 - 14	III - 14
	Gjithsej	100,0	103,3	103,2	102,9	103,1
B	Industri Nxjerrëse	19,7	103,8	103,2	101,9	102,9
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	14,0	110,6	109,9	108,0	109,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3,9	97,2	96,8	96,2	96,7
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	101,9	101,9	102,0	101,9
C	Industria Përpunuese	56,8	104,1	104,2	104,2	104,2
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,0	105,0	105,1	104,7	104,9
11	Prodhimi i pijeve	2,6	105,0	105,1	104,7	104,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	94,3	94,3	94,3	94,3
13	Përpunimi i tekstileve	0,2	106,3	106,3	106,3	106,3
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,6	103,7	104,4	104,0	104,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,0	112,0	111,9	111,4	111,8
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,0	109,6	109,9	110,0	109,8
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,6	104,2	104,7	104,7	104,6
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,8	93,2	93,3	93,3	93,3
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	5,4	112,4	112,4	112,4	112,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,7	96,9	96,8	96,8	96,9
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,2	96,9	96,8	96,8	96,9
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,2	115,8	115,8	115,7	115,8
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	9,3	101,9	101,8	101,6	101,8
24	Metalurgjia	8,2	93,7	94,1	95,0	94,3
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,2	106,0	106,0	106,0	106,0
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,2	103,5	103,5	103,5	103,5
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,3	107,0	107,0	107,1	107,1
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,1	109,4	109,4	110,0	109,6
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysërimorkiove	0,0	100,0	100,0	100,0	100,0
31	Prodhimi i mobiljeve	1,6	110,9	110,9	110,9	110,9
32	Industri të tjera p.k.t	1,2	107,5	107,5	107,6	107,5
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,2	110,7	110,7	111,4	111,0
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	20,5	100,2	100,2	100,2	100,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	20,5	100,2	100,2	100,2	100,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,0	104,4	103,9	104,1	104,1
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,7	110,6	110,6	110,6	110,6
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	91,7	90,7	91,2	91,2

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

		%		
NVE	Përshkrimi	Peshat	III-14/II-14	III-14/II-13
	Gjithsej	100,0	0,1	0,3
B	Industri Nxjerrëse	19,7	1,0	1,9
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	0,0	0,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	14,0	0,6	3,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3,9	2,3	0,6
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	0,9	2,6
C	Industria Përpunuese	56,8	-0,3	-0,1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	9,0	0,5	-1,9
11	Prodhimi i pijeve	2,6	0,5	-1,9
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	-6,7	1,6
13	Përpunimi i tekstileve	0,2	1,4	4,8
14	Konfeksionimi i veshjeve	3,6	-0,1	0,2
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	4,0	-0,6	0,9
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,0	0,0	3,3
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,6	2,4	2,0
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,8	-0,2	-4,0
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	5,4	-0,1	0,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,7	-0,3	-2,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,2	-0,3	-2,4
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,2	-0,2	2,3
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	9,3	-2,1	2,7
24	Metalurgjia	8,2	0,6	-0,2
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,2	0,1	-1,3
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,2	0,8	-2,5
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,3	1,9	-1,0
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,1	0,1	0,8
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,0	0,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	1,6	0,1	0,2
32	Industri të tjera p.k.t	1,2	0,1	-1,0
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,2	0,1	2,1
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	20,5	0,0	0,2
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	20,5	0,0	0,2
E	Fumizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,0	0,0	3,1
36	Fumizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,7	0,6	3,6
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	-0,7	4,2

Tab. 3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	07 - 14	08 - 14	09 - 14	III - 14	III-14 / II - 14
	Gjithsej	100,0	102,6	102,5	102,4	102,5	-0,1
B	Industri Nxjerrëse	25,3	110,7	110,1	108,7	109,8	1,0
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	19,7	120,1	119,3	117,3	118,9	0,5
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3,8	110,6	110,6	110,0	110,4	0,4
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	101,7	101,8	102,0	101,8	1,3
C	Industria Përpunuese	41,3	103,4	103,5	103,5	103,5	-0,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,1	105,4	105,2	105,2	105,3	0,0
11	Prodhimi i pijeve	2,1	105,4	105,2	105,2	105,3	0,0
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	99,0	99,0	99,0	99,0	-6,8
13	Përpunimi i tekstileve	0,1	106,6	106,6	106,6	106,6	0,0
14	Konfeksionimi i veshjeve	1,1	103,0	103,1	102,9	103,0	-0,3
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1,9	119,1	119,1	119,1	119,1	-1,8
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0,4	102,4	102,5	103,0	102,6	0,4
17	Prodhimi i letres dhe produkteve prej letre	0,3	102,3	102,3	102,3	102,3	0,0
18	Shtypshkrimi dhe rigupimi i mediave të regjistruara	2,6	99,6	99,6	99,6	99,6	-0,2
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	6,4	108,9	108,9	108,9	108,9	-0,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	0,3	97,8	97,6	97,6	97,7	-0,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,1	97,8	97,6	97,6	97,7	-0,2
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	0,5	114,9	114,9	114,9	114,9	-0,1
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	11,6	97,4	97,3	97,1	97,3	-1,9
24	Metalurgjia	0,6	89,0	89,9	90,1	89,7	0,4
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,2	101,5	101,5	101,5	101,5	-0,4
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	117,6	117,6	117,6	117,6	0,0
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,2	113,5	113,5	113,7	113,6	0,0
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,1	103,1	103,1	105,7	103,9	0,8
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	1,0	110,5	110,5	110,6	110,5	0,7
32	Industri të tjera p.k.t	0,2	110,5	110,5	110,6	110,5	0,7
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,2	102,3	102,3	104,7	103,1	0,7
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	29,3	100,2	100,2	100,2	100,2	0,0
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	29,3	100,2	100,2	100,2	100,2	0,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,1	103,0	102,6	102,8	102,8	0,0
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,5	110,6	110,6	110,6	110,6	0,6
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,7	78,9	78,9	78,9	78,9	0,0

Tab. 4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	07 - 14	08 - 14	09 - 14	III - 14	III-14 / II - 14
	Gjithsej	100,0	104,1	104,3	104,2	104,2	0,3
B	Industri Nxjerrëse	6,8	100,0	99,1	98,8	99,3	4,5
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	0,9	102,4	102,4	102,4	102,4	6,1
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	4,2	92,2	90,9	90,4	91,2	6,1
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	1,7	103,2	103,2	103,2	103,2	-0,2
C	Industria Përpunuese	92,7	105,3	105,6	105,6	105,5	0,0
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	13,3	102,8	103,2	102,3	102,7	1,1
11	Prodhimi i pijeve	4,0	101,2	101,6	100,7	101,2	1,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,6	108,0	108,0	108,0	108,0	1,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	9,2	104,1	105,0	104,6	104,6	-0,1
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	9,0	111,9	111,9	111,1	111,6	0,0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	2,3	112,6	113,0	112,8	112,8	-0,1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	1,5	105,4	106,2	106,2	106,0	3,3
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	3,4	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,6	100,7	100,7	100,7	100,7	-0,3
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,6	96,9	96,9	96,9	96,9	-0,3
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	2,8	120,4	120,4	120,4	120,4	-0,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	4,3	112,5	112,5	111,8	112,3	-3,2
24	Metalurgjia	26,1	101,7	102,1	103,0	102,3	0,6
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	7,3	109,5	109,5	109,5	109,5	0,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,4	98,9	98,9	98,9	98,9	0,9
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	1,4	108,4	108,4	108,4	108,4	2,4
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p.k.t	0,4	110,9	110,9	110,9	110,9	0,0
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	3,2	109,9	109,9	109,9	109,9	-0,3
32	Industri të tjera p.k.t	0,8	106,1	106,1	106,1	106,1	-0,1
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,5	101,9	101,9	101,9	101,9	0,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	0,5	106,0	96,1	101,1	101,1	-6,1
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	0,5	106,0	96,1	101,1	101,1	-6,1

Informacion për përdoruesit

INSTAT në vijim të procesit të llogaritjes dhe publikimit të treguesve statistikorë, publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për tremujorin e tretë 2014 mbështetur në Nomenklaturën e Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.2. Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev,2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014, <http://www.instat.gov.al/media/252541/nve.pdf>.

INSTAT gjithashtu si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, ka përditësuar periudhën referuese të llogaritjes së indeksit nga 2005 = 100 në 2010 = 100.

Për kalimin e aktiviteteve ekonomike nga nomenklatura e vjetër në nomenklaturën e re si dhe për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore u përdorën matricat e konvertuara të llogaritura mbi rezultatet e Anketave Strukturore Pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo-bujqësore. Seria kohore e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit, për periudhën 2005 – Tremujori i Tretë 2014 është revizionuar me rezultatet e llogaritura në nivel produkti 6-shifror dhe aplikimi i Nomenklaturës së re u realizua në nivel mikro. Kjo solli ndryshim të disa rezultateve të publikuara më parë në nivel të agreguar 2 shifror dhe në nivel seksioni.

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industria Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe

produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit do të ketë si periudhë referuese vitin 2010 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korentë (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1).

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2010}^{2010,M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Me qëllim prodhimit e të dhënave në formën e serive kohore afatgjata indekset janë rillogaritur duke aplikuar matricat e konvertuara në nivel mikro (6 – shifror) e cila sjell revizionim të rezultateve të publikuara më parë. Për të patur seri kohore më konsistente dhe më të krahasueshme me seritë kohore me periudhë referuese 2005 = 100, u revizionuan të gjithë të dhenat e publikuara më parë me NVE.Rev.2 dhe 2010 = 100.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.